



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKI I KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Primer / Datozuar Priljepljen / Priljeplato Recieved / Delivered	05-05	2021	viti god. year
Organ / Iqesta Organ / Zëdhënica Org. / list	No Prot No Prot Prot. No	Shtypja Printed Appendix	Sasia Quantity Quantity
SKPM/SHK	2191/2021		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.189/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2771/19 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.520/2019 të datës 06.09.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi, Rr.“Besnik Restelica” Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit/Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike “transferim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.520/2019 e datës 06.09.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. Prot:6527 i datës 18.06.2019 i Komisionit Disiplinor, Vendimi me Nr.01/8785 i datës 15.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, si dhe Vendimi me Nr.9144/2019 i datës 23.08.2019 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të zbatojë këtë vendim, brenda afatit 15 ditore nga dita e pranimt të tij, duke kthyer ankuesin në pozitën e punës sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2013.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



Arsyetim

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, me datë 06.09.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4157/2019 të regjistruar me numër A.nr 520/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.prot: 6527/2019 të datës 18.06.2019 të Komisionit Disiplinore, dhe Vendimit Nr.prot: 8785 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, me datë 16.09.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën të Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit. Këshilli, me datë 18.11.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi të njëjtën kohë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 12.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2771/19, përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 06.09.2019 të parashtruar nga ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër te protokollit 4157/2019 të datës 06.09.2019 te parashtruar ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës: Akt Emërimi i datës 01.08.2013 i ankuesit Vendimi i datës 24.05.2019 me numër te protokollit 5615 i Sekretarit te Përgjithshëm ne Ministrinë e Infrastrukturës: Vendimi i datës 18.07.2019 me numër te protokollit 7807/2019 i Komisionit për zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave: Vendimin e datës 18.06.2019 me numër te protokollit 6527/2019 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë se Infrastrukturës dhe Transportit: Ankesa e datës 15.07.2019 me numër te protokollit 7574/2019 drejtuar Komisionit për zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave: Vendimi i datës 15.08.2019 me numër te protokollit 8785 te Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave: Emali i datës 08.06.2019: emali i datës 12.07.2019: Raporti i Prezencës në Punë: Kërkesat për përgjigje ne ankese e datës 16.09.2019 me numër te protokollit 4329/2019: Përgjigja ne ankese e datës 18.11.2019: Ndryshimi dhe plotësimi i aktit te emërimit i datës 28.02.2019: Vendimi i datës 15.08.2019 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave: Procesverbali i datës 14.08.2019: Vendimi datës 23.08.2019 me numër te protokollit 9144/2019: Emali i datës 30.05.2019: Emali i datës 02.12.2019: Emali i datës 27.05.2019: Njoftimi lidhur me ankesën A.nr.520/2019 i datës 04.11.2019 me numër te protokollit 5160/2019: Deklarata: E-maili i datës 10.06.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse*

Bazuar në provat e administruara të lëndës, është konstatuar se ankuesi i punësuar në pozitën e punës Zyrtar i Lartë i Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, me datë 24.05.2019 përmes Vendimit me numër protokollit 5615 të Sekretarit të

Përgjithshëm, është pezulluar nga puna, me pagesë, për periudhe kohore prej tre (3) muaj, me arsyetimin se ankuesi nuk ka ofruar bashkëpunim të plotë me Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, dhe mos respektim të orarit të punës.

Përveç pezullimit nga detyrat e punës, me datë 30.05.2019, ndaj ankuesi është iniciuar procedurë disiplinore, ku Komisioni Disiplinor pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, pas administrimit të provave ka gjetur se ankuesi: Ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 59 të Ligjit për Shërbimin Civil, për shkak se i njëjti me datë 01.02.2019 nuk ka respektuar orarin e punës, ka lëshuar vendin e punës pa asnjë njoftim dhe arsyeje; Me datë 12.02.2019 nga Sekretari i Përgjithshëm është kërkuar të ndërmerren masa pasi që i njëjti nuk ka respektua vendimin ligjore për ndalesën e Përgjithshëm, lidhur me dërgimin e provave tek auditorët, pra nuk ka ofruar bashkëpunim të plotë me Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të MIT-së, ku me këto veprime janë cenuar dispozitat e nenit 51 paragrafi 3 të Ligjit për Shërbimin Civil, si dhe dispozitat e nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.04/2015 të Kodit të Mirësjelljes në Shërbimin Civil. Me këtë rast i njëjti ka bërë shkelje të nenit 59 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 7 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2010 të Orarit të Punës në Shërbimin Civil. Andaj, duke u bazuar në këto të gjetura, Komisioni Disiplinor, me datë 18.06.2019, ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 6527, përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *“Largim nga Zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim gradini për një periudhe kohore prej pesë (5) vjet”*.

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor, ankuesi me datë 15.07.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në MIT. Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 15.08.2019, ka nxjerr Vendimin Nr.01/8785 me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit dhe e ka lënë në fuqi Vendimin me numër protokollit 6527 të datës 18.06.2019, të Komisionit Disiplinor.

Bazuar në Vendimin me numër protokollit 6527 të datës 18.06.2019, të Komisionit Disiplinor, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, me datë 23.08.2019 ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 9144 përmes të cilit ka transferuar ankuesin në mënyrë të përhershme nga pozita e punës Zyrtar i Lartë i Prokurimit, në Divizionin e Prokurimit/ Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, në pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa pranë Divizionit të Mbështetjes Teknike, Pronave, Sigurisë Rrugore dhe Peshoreve/ Departamenti për Menaxhimin e Rrugëve, në MIT.

Kundër Vendimit Nr.01/8785 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi me datë 06.09.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes dhe zbatimit të gabuar të ligjit dhe procedurave të shërbimit civil; vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike; masës së shqitura disiplinore. Me tutje ankuesi kërkon që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar dhe të anulohet Vendimi Nr.01/8785 i datës 15.08.2019 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve, dhe Vendimi me numër protokollit 6527 i datës 18.06.2019, i Komisionit Disiplinor, të MIT-se, dhe i njëjti të kthehet në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës sipas Akt Emërimit.

Ankuesi me datë 08.12.2020 përmes shkresës me numër protokolli 3016/2020 ka njoftuar se i njëjti nuk është i interesuar të procedohet me tutje lidhur me pjesën e ankesës që ka të bëjë me pezullimin e tij nga puna për periudhe prej tre (3) muaj. Andaj, përkitazi me njoftimin e ankuesit, Kolegji nuk u lëshua në trajtimin e këtij pretendimi ankimor.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për shkelje dhe zbatimit të gabuar të ligjit dhe procedurave të shërbimit civil, Kolegji ka shqyrtuar provat e lëndës, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se procedura disiplinore andaj ankuesit është iniciuar me datë 30.05.2019, dhe ankuesi është shpallur përgjegjës për shkak se i njëjti me datë 01.02.2019 nuk ka respektuar orarin e punës, ka lëshuar vendin e punës pa asnjë njoftim dhe arsyeje. Përkitazi me këtë konstatim, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se iniciimi i procedurës disiplinore dhe përcaktimi i përgjegjësisë ndaj ankuesit, për mos respektim të orarit të punës, nuk është bërë konform dispozitave ligjore përkatëse, sepse dy mungesa të paarsyeshme në kohëzgjatje një ditore brenda viti kalendarik konsiderohet shkelje e lehtë disiplinore, dhe shqiptimi i masës disiplinore bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo udhëheqësi me i lartë administrativ i institucionit përkatës, brenda afatit prej (2) ditëve të punës, respektivisht prej (7) ditëve nga dita kur dyshohet se është kryer shkelja, siç përcaktohet me nenin 5 dhe 7 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil. Ndërsa neni 12 i kësaj rregullore përcakton se: 1. Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze, në afat prej 2 ditë pune do ta paraqes rastin të udhëheqësi i njësisë se personelit; 2. Pas marrjes së njoftimit udhëheqësi i njësisë se personelit, shkeljen e dyshuar ia kalon për shqyrtim Komisionit Disiplinor të institucionit përkatës. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor, me rastin e konstatimit të shkeljes dhe përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore, nuk ka marrë parasysh natyrën e shkeljes, afatet procedurale, dhe autorizimin ligjor për trajtimin e shkeljeve, duke vepruar kështu në kundërshtim në dispozitat e Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me konstatimin e Komisionit Disiplinor se ankuesi është përgjegjës, për shkak se i njëjti nuk e ka respektuar vendimin ligjor të Sekretarit të Përgjithshëm dhe nuk ka respektuar vendimin mbi ndalesën e [] në Zyrën e Prokurimit në MIT, vlerëson se ankuesi nuk mund të shpallet përgjegjës për një veprim për të cilin nuk është argumentuar me asnjë prove, se i njëjti e ka ftuar në zyre [] Lidhur me këtë çështje, kolegji ka administruar si prove deklaratën me shkrim, të nëpunësit civil [] i cili deklaroi se: "...pasi që thuhet se [] ka pranuar z. [] në zyrën e prokurimit A/103 e cila datë nuk më kujtohet, desha të shkaroj se në ditën kritike afërsisht ka ora 15:30 në zyre kam qenë vetëm unë kur ka ardhur z. [] ndërsa z. [] ka ardhur me vonë para orës 16:00 ku të dy se bashku punojmë në të njëjtën zyre". Andaj, përkitazi me këtë konstatim, Kolegji vlerëson se Komisionit Disiplinor nuk ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, duke mos marrë në shqyrtim provat për vërtetimin e këtij pretendimi, kështu që ka vepruar në kundërshtim me nenin 71 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 13 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, si dhe dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 48 ku përcaktohet se: 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve.

Ndërsa, lidhur me konstatimin se ankuesi nuk ka realizuar kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të datës 24.05.2019 ku kërkohet nga ankuesi dërgimi i provave të auditorët, Kolegji gjatë administrimit të provave ka gjetur shkresën e datës 08.06.2019 dhe 10.06.2019 të Zyrës Kombëtare të Auditimit, përmes të cilave konfirmohet se ankuesi ka pasur një bashkëpunim të mirë me auditorët duket ofruar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, andaj Kolegji duke marr parasysh këtë komunikim zyrtar, vlerëson se ankuesi ka respektuar dispozitat ligjore në fuqi, ndërsa Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të konstatoj drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, dhe të aplikoje drejtë ligjin material, duke shkaktuar pasiguri të ankuesi dhe përveç që ka bërë shkelje procedurale ka bërë shkelje edhe të ligjit material në dëm të ankuesit.

Andaj, bazua në konstatimet e lartcekura, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 6527 të datës 18.06.2019, ka vepruar në kundërshtim nënin 66, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1. Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara, në kundërshtim me dispozitat e Rregullores 04/2011, për Procedura Disiplinore në Shërbimin Civil, dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.01/8785 të datës 15.08.2019 përmes të cilën ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 si dhe nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji në mënyrë unanime vendosi të aprovoje ankesën e ankuesit si të bazuar, të anuloi Vendimit me numër protokollit 6527 të datës 18.06.2019 të Komisionit Disiplinor dhe Vendimit me Nr.01/8785 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, dhe çdo veprim tjetër që pason nga këto vendime, si dhe obligojë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të kthejë ankuesin në pozitën e tij të punës, si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.189/2021.

Aydyl BEKTESHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

